



## REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

### AGJENCIA E SHËRBIMEVE MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUALE

PA1 Nr.08-213

29.07.2022

Shkup

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 2 dhe neni 83 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr.42/20 dhe 77/21), dhe në lidhje me nenin 82 paragrafi (1) nënparagrafi 5 nga Ligji i njëjtë, neni 51 paragrafi (1) dhe paragrafi (3) dhe neni (52) paragrafi (2) nga Ligji i Procedurës së Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.124/15), neni 28 nga Ligji i Kontesteve Administrativ (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr.96/19), duke vepruar sipas Propozimit PA1 nr. 08-213 datë 15.7.2022, për inicim të procedurës për heqjen dhe Popozimin PA1 nr.08-213 datë 28.7.2022 e të autorizuarit nga drejtori i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në pajtim me Autorizimin me Nr. ark.03-2528/1 datë 27.6.2022, për vendimin e heqjes së lejes së radiotransmetimit të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive KAPITOL FM SHPKNJP Shkup, në pajtim me Konkluzionin, ark.nr.02-2964/2 datë 29.7.2022, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në seancën e 29-të mbajtur më 29.7.2022 miratoi:

#### Vendim

#### **për marrjen e lejes së radiotransmetim të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive KAPITOL FM SHPKNJP Shkup**

1. Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive KAPITOL FM SHPKNJP Shkup i HIQET leja e radiotransmetimit PA1 nr. 08-81 datë 5.1.2015, për shkak se pas dhënies së lejes ndodhën situata që paraqesin pengesa Ligjore për zotëruesin e lejes për kryerjen e veprimtarisë së tij – marrje të lejes për shfrytëzim të radiofrekuencave të dhëna nga AKE-ja si kusht bazë për kryerjen e veprimtarisë – transmetim të shërbimeve programore në radio.

2. Ky vendim botohet në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”, në uebfaqen e Agjencisë dhe në dy gazeta ditore, prej të cilave njëra është në gjuhën e bashkësisë joshumicë, por që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

3. Ky Vendim është përfundimtar.

#### **A r s y e t i m**

Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) KAPITOL FM SHPKNJP Shkup, është zotërues i lejes së radiotransmetimit, PA1 nr.08-81 datë 5.1.2015, për transmetim nëpërmjet transmetuesit tokësor, në nivel rajonal (për zonën e qytetit të Shkupit), shërbim programor radiomuzikor me format të përgjithshëm, në gjuhën maqedonase.

Në pajtim me nenin 68 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale – LSHMAAV, lejen e transmetimit në televizion dhe radio e jep Agjencia, për nivel të caktuar të shikueshmërisë ose dëgjueshmërisë (shtetëror, rajonal ose lokal), ndërkaq zotëruesi i lejes fiton të drejtën të transmetojë shërbimin programor në radio ose televizion në zonën për të cilën ka marrë lejen.

Në bazë të lejes së marrë për radiotransmetim me shfrytëzimin e radiofrekuencave, Agjencia e Komunikimeve Elektronik (AKE) miraton shfrytëzimin e radiofrekuencave në pajtim me Ligjin e Komunikimeve Elektronik (LKE). Për shfrytëzimin e radiofrekuencave, paguhet tarifë vjetore në llogari të AKE-së për çdo vit aktual paraprakisht duke filluar nga data e vlefshmërisë së miratimit për shfrytëzim të radiofrekuencave.

Më 27.4.2022, ASHMA-ja pranoi Njoftim nga AKE-ja me Nr. ark 0805-178 datë 14.4.2022. (Nr. ynë ark. 03-1788/1) për miratimet e marra për shfrytëzim të radiofrekuencave të shoqërive të caktuara tregtare radiodifuzive, duke përfshirë dhe SHTR KAPITOL FM SHPKNJP Shkup, për kompensimet e papaguara për shfrytëzim të radiofrekuencave. Në shtojcë të Njoftimit ishte dorëzuar dhe Vendim i AKE-së, PA1 nr. 0802-2022 datë 22.3.2022., për marrjen e miratimeve për shfrytëzim të radiofrekuencave, në shërbimin radiodifuziv me numër evidence 102991 dhe në shërbimin e transmetimit fiks me numër evidence 102992, të lëshuara nga AKE-ja për shfrytëzuesin SHTR KAPITOL FM SHPKNJP Shkup.

Në pajtim me nenin 82 paragrafi (1) nënparagrafi 5 të LSHMAAV-së, ASHMA-ja do të marrë lejen e transmetim në radio dhe televizion para përfundimit të afatit për të cilën është dhënë dhe do të fshijë radiodifuzerin nga regjistri i transmetuesve, paraprakisht duke i dorëzuar njoftim me shkrim që nëse pas dhënies së lejes krijohen rrethana që paraqesin pengesa Ligjore për zotëruesin e lejes për kryerje të veprimtarisë.

Në funksion të saj, dhe duke pasur parasysh Vendimin e cituar të AKE-së, për marrjen e lejeve për shfrytëzim të radiofrekuencave shfrytëzuesit SHTR KAPITOL FM SHPKNJP Shkup, radiodifuzerët i është dërguar Shkresë-Njoftim (Nr. ynë ark. 03-1788/5 datë 3.5.2022), se krijimi i rrethanave (pas dhënies së lejes), që paraqesin pengesa Ligjore për zotëruesin e lejes për kryerje të veprimtarisë, paraqet bazë për marrjen e lejes për radiotransmetim në pajtim me nenin e lartpërmendur të LSHMAAV-së, si dhe për nevojën që sa më parë të tejkalojë gjendjen e konstatuar dhe për këtë të njoftohet ASHMAAV-ja. Shkresa e lartpërmendur ishte pranuar nga SHTR KAPITOL FM SHPKNJP Shkup më 4.5.2022.

Në lidhje me këtë që u tha më lartë, Sektori i mbështetjes informatike dhe i punëve të përgjithshme pranë ASHMAAV-së, anëtarëve të Këshillit të ASHMAAV-së dhe drejtorit të ASHMA-së, u dorëzoi Vërejtje zyrtare (Nr. ynë ark. 03-1788/2 datë 27.4.2022.), se shoqëri të caktuara tregtare si dhe SHTR KAPITOL FM SHPKNJP Shkup do të jenë nën mbikëqyrje administrative deri më 18.5.2022., me rastin e Njoftimit të AKE-së për marrje të miratimeve për shfrytëzim të radiofrekuencave, dhe me qëllim për të përcaktuar nëse transmetojnë shërbime programore në radio.

Në drejtim të ndërmarrjes së veprimeve të mëtejshme nga aspekti i dispozitave nga LSHMAAV-ja, dhe duke pasur parasysh se ASHMAAV-ja nuk zotëron mundësi teknike për inçizim të shërbimeve programore në radio në nivel lokal, është dërguar Shkresë – Kërkesë informimi drejtuar AKE-së (Nr. ynë ark. 03-1788/3 datë 28.4.2022.), për dorëzim të të dhënave të hollësishme për datën prej kur SHTR KAPITOL FM SHPKNJP Shkup nuk transmeton shërbim programor në radio, si dhe për datën e marrjes së vendimit për marrje të miratimeve për shfrytëzim të radiofrekuencave. Më datë 19.5.2022, AKE-ja i dërgoi ASHMAAV-së Njoftim – Shkresë e të dhënave të hollësishme, PA1 nr. 0805-178 datë 11.5.2022. (Nr. ynë ark. 03-1788/10), se data e matjes sipas orarit kur SHTR KAPITOL FM SHPKNJP Shkup nuk ka transmetuar shërbime programore në radio ishte më 6.5.2022, si dhe Vendimin për marrje e pranoi më datë 18.4.2022.

Me qëllim që ASHMAAV-ja të vazhdojë me marrjen e veprimeve të mëtejshme në aspekt të dispozitave të LSHMAAV-së, dhe me rastin e dorëzimit të njoftimit të cituara, ASHMAAV-ja më 28.6.2022 i dorëzoi AKE-së Shkresë-Kërkesë informacioni (Nr. ynë ark. 03-1788/14 më 28.6.2022.), nëse te SHTR KAPITOL FM SHPKNJP Shkup ka ndryshime në lidhje me shfrytëzimin e radiofrekuencave, duke pasur parasysh që AKE-ja ia ka marrë miratimet e shfrytëzimit të radiofrekuencave. Më 6.7.2022 AKE-ja dorëzoi te ASHMAAV-ja Njoftim me Nr. ark. 0805-1998/5 datë 6.7.2022. (Nr. ynë ark. 03-1788/15), në lidhje me marrjen e lejimit për shfrytëzimin e radiofrekuencave të SHTR KAPITOL FM SHPKNJP Shkup, në të cilën theksoi se AKE-ja i ka marrë lejen për shfrytëzimin e radiofrekuencave të SHTR KAPITOL FM SHPKNJP Shkup me seli në rr. "Kozle" nr. 12, Shkup, si dhe në bazën e lejeve aktive të AKE-së shfrytëzuesi i përmendur nuk ka ekzistuar më. Me rastin e dorëzimit të njoftimit të cituar nga AKE-ja, Sektori i mbështetjes informatike dhe i punëve të përgjithshme pranë ASHMAAV-së dorëzoi te anëtarët e Këshillit të ASHMAAV-së dhe te drejtori i ASHMAAV-së Vërejtje zyrtare (Nr. ynë ark. 03-1788/16 datë 7.7.2022), me propozim për iniciimin e procedurës për marrjen e lejes për transmetim të SHTR KAPITOL FM SHPKNJP Shkup, bazuar në nenin 82 paragrafi 1 nënparagrafi 5 të LSHMAAV-së, përkatësisht për shkak se është konstatuar se pas lëshimit të lejes janë krijuar rrethana që paraqesin pengesa ligjore që zotëruesi i lejes ta realizojë – marrje e lejes për shfrytëzimin e radiofrekuencave, të lëshuar nga AKE-ja, si kusht bazë për kryerjen e veprimtarisë – transmetim të servisit programor në radio.

Në nenin 23, paragrafi 1, nënparagrafi 3 të LSHMAAV-së është përcaktuar se nëse konstatohen parregullsi dhe shkelje të dispozitave të LSHMAAV-së dhe të akteve nënligjore, të miratuara me ligj, si dhe të kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara me lejen dhe aktet e tjera të ASHMAAV-së, kundër botuesit të medias, Këshilli i ASHMA-së mund të marrë masë – marrjen e lejes.

Procedurën e marrjes së lejes së transmetimit të radios ose të televizionit, në pajtim me nenin 83, paragrafi 1 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale, e inicon këshilli me propozim të drejtorit të ASHMA-së.

Duke pasur parasysh gjendjen faktike të konstatuar, dhe duke pasur parasysh që pas lëshimit të lejes janë krijuar rrethana që paraqesin pengesa ligjore që zotëruesi i lejes të kryejë veprimtarinë – marrja e lejes për shfrytëzimin e radiofrekuencave të lëshuar nga AKE-ja si kusht bazë për kryerjen e veprimtarisë – transmetimi i servisit programor në radio (neni 82 paragrafi 1 nënparagrafi 5 të LSHMAAV-së), drejtori i Agjencisë, Dr. Zoran Trajčevski në bazë të nenit 83 paragrafi 1 të LSHMAAV-së, e në lidhje me nenin 82 paragrafi 1 nënparagrafi 5, dorëzoi propozim PA1 nr. 08-213 datë 15.7.2022 për iniciimin e procedurës për marrjen e lejes së transmetimit të radios të SHTR KAPITOL FM SHPKNJP Shkup, PA1 nr.08-81 datë 5.1.2015.

Këshilli i ASHMAAV-së në seancën e 27-të, mbajtur më 19.7.2022, me Konkluzion me Nr. tonë ark. 02-2808/4 datë 19.7.2022, e miratoi Propozimin PA1 nr. 08-213 datë 15.7.2022, për iniciimin e procedurës për marrjen e lejes së transmetim të radios të SHTR KAPITOL FM SHPKNJP Shkup, PA1 nr. 08-81 datë 5.1.2015, paraqitur nga propozuesi, drejtori i Agjencisë, Dr. Zoran Trajčevski.

Në lidhje me procedurën e inicuar për marrjen e lejes për transmetim të radios të SHTR KAPITOL FM SHPKNJP Shkup, PA1 nr.08-81 datë 5.1.2015, dhe në pajtim me nenin 82, paragrafi 1, nënparagrafi 5 të LSHMAAV-së, ASHMAAV-ja i dërgoi njoftim transmetuesit në fjalë, PA1 nr. 08-213 datë 20.7.2022, në të cilin theksohet se nëse nuk i largon pengesat ligjore për kryerjen e veprimtarisë – transmetim të servisit programor në radio, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga pranimi i propozimit të drejtorit të Agjencisë, PA1 nr. 08-213 datë 15.7.2022, do të marrë vendim për marrjen e lejes së tij për transmetim të radios, pas së cilës në pajtim me nenin 85, paragrafi 2 të LSHMAAV-së, transmetuesi do të fshihet nga regjistri i transmetuesve. Njoftimi PA1 nr. 08-213 datë 20.7.2022, është dërguar deri te SHTR KAPITOL FM SHPKNJP Shkup në

formë të shkruar, ndërkaq në librin e Agjencisë është shënuar se e njëjta është pranuar në mënyrë të rregullt më 21.7.2022.

Me rastin e njoftimit të dorëzuar nga SHTR KAPITOL FM SHPKNJP Shkup PA1 nr. 08-213 datë 20.7.2022, nga ana e përfaqësuesit të radiodifuzerit më 25.7.2022 deri te ASHMAAV-ja ishte dorëzuar përgjigje ndaj Njoftimit PA1 nr. 08-213 datë 25.7.2022, në të cilin është dhënë sqarim lidhur me kontestin administrativ të iniciuar kundër Aktvendimit për fshirje të SHTR KAPITOL FM SHPKNJP Shkup nga Regjistri Qendror i RMV-së, për shkak së cilës propozohet iniciimi për marrjen e lejes të SHTR KAPITOL FM SHPKNJP Shkup, që të shtyhet deri në përfundimin e pakthyeshëm të procedurës së kontestit administrative para gjykatës kompetente. Këshilli i ASHMAAV-së vendosi që të mos e pranojë propozimin për shtyrjen e procedurës së iniciuar për marrjen e lejes, sepse nga rezultati i kontestit administrativ varet nëse radiodifuzeri do të fshihet si subjekt juridik nga RQRMV-ja, përkatësisht nëse si zotërues i lejes nuk do të ekzistojë më sipas nenit 85 paragrafi 1 nënparagrafi 3 të LSHMAAV-së, në bazë të të cilit ASHMAAV-ja nuk ka ndërmarrë veprime pikërisht për shkak të kontestit administrativ të papërfunduar. Për këtë që u përmend, ASHMAAV-ja e ka njoftuar me shkrësë radiodifuzerin.

Me qëllim që të vërtetohet nëse edhe pas inicimit të procedurës për marrjen e lejes radiodifuzeri ka harmonizuar punën e tij me dispozitat ligjore të LSHMAAV-së dhe i ka menjanuar pengesat ligjore për kryerjen e veprimtarisë-marrje të lejeve për shfrytëzimin e radiofrekuencës, lëshuar nga AKE-ja si kusht bazë për kryerjen e veprimtarisë - transmetim të servisit programor në radio, ASHMAAV-ja dërgoi përsëri te AKE-ja Kërkesë informacioni (PA1 nr. 08-213 datë 20.7.2022), nëse te SHTR KAPITOL FM SHPKNJP Shkup ka ndryshim në lidhje me shfrytëzimin e radiofrekuencave, duke pasur parasysh se i janë marrë lejet për shfrytëzimin e radiofrekuencave, nga AKE-ja. Deri te ASHMAAV-ja më 26.7.2022, AKE-ja dorëzoi Shkrësë – Njoftim i përsëritur, Nr. ark. 0805-1998/7 datë 25.7.2022 (Nr. ynë ark. PA1 nr. 08-213), që AKE-ja i ka marrë lejet për shfrytëzimin e radiofrekuencave të SHTR KAPITOL FM SHPKNJP Shkup, me seli në rr. "Kozle" nr. 12/1, Shkup, dhe se duke përfshirë datën 22.7.2022, në bazën aktive të të lejeve të AKE-së nuk ekziston më shfrytëzuesi SHTR KAPITOL FM SHPKNJP Shkup.

Në pajtim me nenin 83, paragrafi 3 të LSHMAAV-së, këshilli është i detyruar që në afat prej 15 ditësh nga pranimi i propozimit të drejtorit, të fillojë procedurën për marrjen e lejes, të miratojë vendim me shumicë votash të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit.

Duke pasur parasysh faktin e verifikuar se zotëruesi i lejes PA1 nr. 08-81 datë 5.1.2015, SHTR KAPITOL FM SHPKNJP Shkup dhe në pajtueshmëri me dërgimin e Shkrësës-Njëftim i përsëritur, i fundit, i AKE-së, Nr. ark. 0805-1998/7 datë 25.7.2022 (Nër. ynë ark. PA1 nr. 08-213 datë 26.7.2022) dhe në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita pranimit të propozimit të drejtorit të ASHMAAV-së, PA1 nr. 08-213 datë 15.7.2022 nga ana e Këshillit të ASHMAAV-së, nuk e ka harmonizuar punën në përputhje me LSHMAAV-në dhe nuk i ka hequr pengesat ligjore për kryerje të veprimtarisë – marrja e lejeve për shfrytëzimin e radiofrekuencave, të lëshuara nga AKE-ja si kushti bazë për kryerjen e veprimtarisë radiodifuzive-transmetim të servisit programor në radio, bazuar në nenin 82 paragrafi 1 dhe nënparagrafi 5 të LSHMAAV-së, dhe në pajtueshmëri me Propozimin PA1 nr. 08-213 datë 28.7.2022 për miratimin e vendimit për marrjen e lejes për transmetim të radios të SHTR KAPITOL FM SHPKNJP Shkup nga e autorizuarra Mr. Dragica Ljubevska, në pajtueshmëri me Autorizimin, Nr. ark. 03-2528/1 datë 27.6.2022 dhe Konkluzioni i Agjencisë, Nr. ark. 02-2964/2 datë 29.7.2022, u miratua Vendim që i merr lejen për radiotransmetin SHTR KAPITOL FM SHPKNJP Shkup, PA1 nr. 08-81 datë 5.1.2015, për shkak se pas marrjes të lejes janë krijuar rrethana që paraqesin pengesa ligjore që zotëruesi i lejes ta kryejë veprimtarinë – transmetim të servisit programor në radio.

Në pajtim me nenin 84 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale, vendimi për marrjen e lejes për transmetim në radio ose televizion është përfundimtar, ndërkaq kundër tij, zotëruesi i lejes ka të drejtë që të parashtrojë padi te gjykata kompetente në afat prej 30 ditëve nga pranimi i tij. Procedura para gjykatës kompetente është urgjente.

Në bazë të gjithë kësaj që është theksuar më lartë, u mor vendimi si në dispozitiv.

**Agjencia e Shërbimeve Mediatike  
Audio dhe Audiovizuale  
Kryetari i Këshillit,**

**Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi për marrjen e lejes për radiotransmetim, Shoqëria Tregtare Radiodifuzive SHTR KAPITOL FM SHPKNJP Shkup ka të drejtë padie para gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga pranimi i tij.